



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna Hani i Elezit / Municipality of Hani i Elezit



01.Nr 145 /2013

Data: 09.01.2013

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 (të shpallur në Gazetën Zyrtare Nr. 28/2008) neni 40 pika 1, neni 73, Udhëzimit Administrativ Nr.2008/10 për organizimin dhe funksionimin e Komiteteve Konsultative neni 4, Statutit të Komunës neni 30, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit shpall:

K O N K U R S

PËR PLOTËSIMIN E ANËTARËVE PËR TRI KOMITETET KONSULTATIVE NË KOMUNËN E HANIT TË ELEZIT

1. Komiteti Konsultativ për Arsim, Kulturë, Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale (1 anëtarë).
2. Komiteti për Zhvillim Ekonomik, Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Ambientit (1 anëtarë).
3. Komiteti për Shërbime Publike dhe Emergjencë (3 anëtarë).

Detyrat dhe përgjegjësit:

- Japin propozime për rregullore të ndryshme sipas lëmive përkatëse.
- Japin mendime dhe ide rreth iniciativave që i ndërmerr Kryetari i Komunës, Komitetet e përhershme apo Kuvendi i Komunës në fushat përkatëse.
- Paraqesin pikëpamje dhe mendime të qytetarëve te Kryetari i Komunës dhe Kuvendi i Komunës.
- Paraqesin propozime për zgjidhjen e problemeve të identifikuara.
- Paraqesin ide apo propozime për hulumtime të ndryshme.

Mandati:

Mandati i parë i anëtarëve të Komiteteve Konsultative është 3 (tre) vjeçar në baza të rregullta ku 1/3 (një e treta) e anëtarëve duhet të ndërrohet çdo vit.

Anëtarët e Komiteteve Konsultative mund të shërbejnë më së shumti për dy mandate të njëpasnjëshme si anëtarë të atyre komiteteve.

Kompensimi:

Për punën e tyre në Komitetet Konsultative, anëtarët e këtyre komiteteve do të kompensohen konform me dispozitat e nenit 9 të Udhëzimit Administrativ Nr. 16/ 2008 për pagesën e Stafit politik në Komuna.

Kushtet:

1. Të drejtë për të marrë pjesë në konkursin për anëtarësim në Komitetin Konsultativ kanë të gjithë qytetarët dhe përfaqësuesit e organizatave joqeveritare të Komunës së Hanit të Elezit të cilët janë njohës të fushave përkatëse.
2. Përfaqësimi gjinor në Komitetin Konsultativ duhet të jetë në kuotën e 30%.
3. Kandidati për anëtar në Komitetin Konsultativ duhet të jetë banor i Komunës së Hanit të Elezit.
4. Përgatitja profesionale- përparësi.

Dokumentet e kërkuara:-

CV

Diploma

Çertifikata e lindjes

Kopje e letërnjoftimit

Çertifikata e vendbanimit

Kandidatët të cilët do të konkurrojnë do t'i nënshtrohen intervistimit.

Afati për dorëzimin e dokumenteve të kërkuara është 15 ditë nga dita e shpalljes në gazetën publike.

Aplikacionet mund të merren në zyrën e pritjes në komunën e Hanit të Elezit.

**Kryesuesi i Kuvendit
Menduh Vlasi**

